



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.119/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj - kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 24.01.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht e bazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, Anr.119/2025 e datës 21.01.2025, ashtu që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 6,000.00 (gjashtëmijë) euro.

II. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 21.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën pretendon se më datë 19.01.2025 është mbajtur tubim i subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje në qytetin e Ferizajt, në këtë tubim kandidati për kryeministër i kësaj partie dhe kryeministri aktual, Albin Kurti, gjatë fjalimit të tij ka bërë shkelje të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, respektivisht nenit 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11, i cili shprehimisht thotë *“përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Më tutje parashtruesi i ankesës ka theksuar se në rastin konkret, video të bashkangjitur në CD ku mund të dëgjoj Paneli edhe me audio dhe video, shihet qartë shkelja e rëndë dhe e pakontestueshme e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme nenit 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.11, madje kjo është sjellje përsëritëse e kandidatit për kryeministër nga radhët e LVV, sepse për të njëjtin fjalor ishte dënua nga PZAP për fjalimin e tij në Pejë në shumë prej 3000 euro sipas Vendimit 30/2025, datë 15.01.2025 dhe Vendimit nr.59/2025, dt.20.01.2025.

Tutje në ankesë ka theksuar se duke u bazuar në gjithë këto prova kërkojmë nga ana e juaj si organ kompetent dhe i autorizuar që të shqiptohet, masë më të lartë sanksionuese ndaj subjektit politik LVV, për shkeljen e përsëritur, që kandidati i tyre për kryeministër ka bërë gjatë fjalimit të tij në tubimin politik në politik në Ferizaj.

Si provë ka bashkangjitur, që dëshmon shkeljen e pretenduar është CD-ja me videon, ku dëgjohet qartazi gjuha nxitëse e provokuese ndaj Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Më datë 22.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më 22.01.2025 në ora 17:00.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 22.01.2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) pasi që provat e bashkangjitura vërejmë se te njëjtat vlejnë për komplet një ngjarje tjetër dhe është jo relevante për objektin e ankesës ashtu siç ankuesi pretendon se ka pasur shkelje. Në përgjigje në ankesë më tutje theksohet se sa i përket pretendimeve të ankuesit se ka pasur gjuhë denigruese nga ana e kryeministrit Kurti dhe ministrit Sveçla e shohim të udhës këto të i demantojmë, dhe se këto deklarata nuk futen në domenin e shkeljeve për arsye se deklaratat e tilla kanë karakter satirik dhe në aspekt krahasues kandidatet në fjalë tenton që partitë konkurruese të paraqes si jo të denjë për votuesin, duke vazhduar në pjesën e dytë të fjalimit ashti siç dëgjohet që thotë “të ecim përpara”. Nga rrethanat e rastit duke analizuar të gjitha provat një nga një dhe të gjitha së bashku kanë propozuar që kjo ankesë të hedhet poshtë si e pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, pas shikimit të video incizimit të ofruar si provë materiale e cila është publikuar shihet se ministri Xhelal Sfeqla ka përdorur gjuhë fyese dhe denigruese duke nxitur urrejtje ndaj këtij subjekti politik, në atë mënyrë që përderisa i ishte drejtuar elektoratit të tij në Ferizaj përdorë fjalët *"Të dashur qytetar unë kam një pyetje për ju, kta bërlloga ato ditë a do ti hedhim në kantën e bërllogut të historisë së kombit tonë, prandaj të dashur qytetarë të rrahim si një zemër, si zemra e kryeministrit që me 9 shkurt ti tregojmë vendin të vjetrës dhe të ecim përpara me Lëvizjen Vetëvendosje"*.

Paneli, konform nenit 13 par. 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 01/2024, me datë 14.01.2025, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara, sepse përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34

pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: *"Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë"*.

Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Andaj Paneli gjeti se gjuha e përdorur ndaj subjektit politik LDK, është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-së ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së. Në këtë rast është marrë për bazë kontekstin dhe qëllimin për të cilin është përdorur gjuha ndaj një subjekti politikë në garë, faktin që deklaratat janë bërë në gjate tubimeve publike te fushatës zgjedhore, andaj sipas Panelit përdorimi i gjuhës së tillë ndaj kundërshtarëve politikë ka për qëllim ofendimin, denigrimin dhe njëherit shihen si shprehje me ngjyrimë përçmuese ose nënvlerësuese. Rregullat që rregullojnë fushatën zgjedhore kërkojnë nga subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre të shmangin përdorimin e gjuhës fyese, denigruese dhe urrejtëse, andaj sipas Panelit përdorimi i kësaj gjuhe në këtë rast konsiderohet si përkeqësim i klimës në të cilën duhet të zhvillohet gara zgjedhore dhe njëherit gjuha e tillë e përdorur mund të rrisë tensione mes subjekteve politike. Nuk mund të konsiderohet që gjuha e tillë që është përdorë ka karakter satirik, përkatësisht interpretimi humoristik e humb kuptimin marrë për bazë kontekstin që është përdorë dhe qëllimin e denigrimit dhe përçmimit të subjektit politik të cilit i është drejtuar.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe të njëjtit subjekt politik për shkelje të natyrës së njëjtë i është shqiptuar gjobë nga PZAP-i, me Vendimin Anr.30/2025, të datës 15.01.2025, Vendimin 59/2025 të datës 20.01.2025.

Ndërsa sa i përket pretendimeve të parashtresës lidhur me shkeljet e mundshme të ligjit si në videon nr. 1 *"Më tha a je lodh, unë i thash bac niher jom tu i lodh opozitën dhe të dashur qytetarë, jo veq tu i lodh por edhe jem tu i sos, e ti skropit , e jemi tu i rraskapit , e jemi tu i dermu, thermu, se e kemi nermen me i shpartallu"*, të njëjtat paneli i refuzoi të pabazuara.

Kjo për faktin se parashtruesi i ankesës i referohet kësaj video, që për Panelin nuk mund të merret se Subjekti politik LVV ka shkelur nenin 34, pika 1.11 të LZP-në gjegjësisht se ka bërë thirrjet për nxitje të urrejtjes.

Andaj duke u mbështetur në dispozitën e sipërcituar Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga ofrimi i provës apo dëshmisë parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkeljet për të cilat pretendohet, pasi që ankesa e parashtruesit ka qenë e pabazuar, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Neni 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“Vendosja për ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, ankesën e parashtruar e konsideron pjesërisht të bazuar konform dispozitës ligjore të nenit 117 paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin të pabazuara, të pa qëndrueshme dhe pa bazë ligjore si në dispozitat e Ligjit për Zgjedhje, dhe si të tilla nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka Paneli, vlerësoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 pika 1.11), nenit 118 par. 1 dhe nenit 120 par. 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 119/2025 më datë 24.01.2025

Kryesues i Panelit
Skender Gocaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.13/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija - Ymeri, kryetare e kolegjit, Milena Djeric dhe Beshir Islami, anëtar të kolegjit, duke vendosur sipas ankesës së subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.119/2025, të datës 24.01.2025, në seancën e mbajtur më datë 29.01.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET ankesa e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ndërsa vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.119/2025, i datës 24.01.2025, VERTETOHET.

A r s y e t i m i

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa Anr.119/2025, të datës 24.01.2025, është vendosur: I. Pranohet pjesërisht e bazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, Anr.119/2025 e datës 21.01.2025, ashtu që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 6,000€. II. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Kundër vendimit të lartpërmendur, subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke pretenduar se vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LZP-së, dhe vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike, duke propozuar që Gjykata Supreme ankesën ta aprovojë, ashtu që të anulohet vendimi A.nr.119/2025, i PZAP-së, ose të ndryshohet, dhe i njëjti të refuzohet si i pa bazuar.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi themel



ankimore dhe propozoi që ankesa e subjektit politik të dënuar me këtë vendim të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi A.nr.55/2025, i datës 19.01.2025, ose të hedhet si e pas afatshme ankesa.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 21.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën pretendon se më datë 19.01.2025 është mbajtur tubim i subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje në qytetin e Ferizajt, në këtë tubim kandidati për kryeministër i kësaj partie dhe kryeministri aktual, Albin Kurti, gjatë fjalimit të tij ka bërë shkelje të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, respektivisht nenit 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11, i cili shprehimisht thotë “përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.

Më datë 22.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më datë 22.01.2025 në ora 17:00

Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), më datë 22.01.2025, ka ushtruar përgjigje në ankesë, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi ankesën e subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë të subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), PZAP-i, ka nxjerr vendimin Anr.119/2025, të datës 24.01.2025, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht ankesën e Subjektit Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), duke vendosur si në dispozitiv të vendimit të ankimuar.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Paneli gjeti se gjuha e përdorur ndaj subjektit politik LDK-së, është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LKP-së, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LKP-së. Në këtë rast është marrë për bazë kontekstin dhe qëllimin për të cilin është përdorur gjuha ndaj një subjekti politikë në garë, faktin që deklaratat janë bërë gjatë tubimeve publike të fushatës zgjedhore, andaj sipas Panelit përdorimi i gjuhës së tillë ndaj kundërshtarëve politikë ka për qëllim ofendimin, denigrimin dhe njëherit shihen si shprehje me ngjyime përçmuese ose nënvlerësuese. Rregullat që rregullojnë fushatën zgjedhore kërkojnë nga subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre të shmangin përdorimin e gjuhës fyese, denigruese dhe urrejtëse, andaj sipas Panelit përdorimi i kësaj gjuhe në këtë rast konsiderohet si përkeqësim i klimës në të cilën duhet të zhvillohet gara zgjedhore dhe njëherit gjuha e tillë e përdorur mund të rrisë tensione mes subjekteve politike. Nuk mund të konsiderohet që gjuha e tillë që është përdorë ka karakter satirik, përkatësisht



interpretimi humoristik e humb kuptimin marrë për bazë kontekstin që është përdorë dhe qëllimin e denigrimit dhe përçmimit të subjektit politik të cilit i është drejtuar.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysht të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe të njëjtit subjekt politik për shkelje të natyrës së njëjtë i është shqiptuar gjobë nga PZAP-i, me vendimin Anr.30/2025, të datës 15.01.2025, vendimin 59/2025 të datës 20.01.2025.

Ndërsa sa i përket pretendimeve të parashtresit të ankesës lidhur me shkeljet e mundshme të ligjit si në videon nr. 1 “Më tha a je lodh, unë i thash bac niher jom tu i lodh opozitën dhe të dashur qytetarë, jo veç tu i lodh por edhe jem tu i sos, e tu i skropit, e jemi tu i raskapitë jemi tu i dërmu, thermu, se e kemi ndermen me i shpartallu”, të njëjtat paneli i refuzoi të pabazuara.

Kjo për faktin se parashtresi i ankesës i referohet kësaj video, që për Panelin nuk mund të merret se subjekti politik LVV ka shkelur nenin 34, pika 1.11 të LZP-në gjegjësisht se ka bërë thirrjet për nxitje të urrejtjes.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me dënimin e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregulloren nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosijes së Ankesave, sepse në mënyrë të sigurt është vërtetuar shkelja nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), e Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatet, e paraparë në nenin 34, 1.11, të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenit 24.9.1 të Rregullores nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosijes së Ankesave. Vendimi i kundërshtuara nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme ishin pretendimet ankimore të subjektit politik të lartpërmendur, dhe përkitazi me konstatimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike ashtu si thekson parashtresi i ankesës dhe se këto pretendime dhe të tjerat në këtë drejtim nga kolegji i kësaj gjykate refuzohen si të pabazuara dhe jo të qëndrueshme sepse PZAP vendimin e saj e bazon në prova konkrete të qarta dhe ekzistuese si CD-ja, që ka vërtetuar pretendimet që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor dhe janë në lidhshmëri me rastin që është objekt i shqyrtimit konkretisht deklaratimet ku theksohet se: “*Të dashur qytetar unë kam një pyetje për ju, këta bërlloga ato ditë a do ti hedhim në kantën e bërllogut të historisë së kombit tonë, prandaj të dashur qytetarë të rrahim si një zemër, si zemra e kryeministrit*”, me çka është shkelur Kodi e



Mirësjelljes dhe në veçanti nenin 34. 1.11. ku parashihet se: “ 1 Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11 përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.

Gjykatës Supreme i rezulton se gjuha e tillë e përdorur në kuadër të fushatës zgjedhore, paraqet shkelje të Kodit të Mirësjelljes dhe për këtë arsye e aprovon qëndrimin e PZAP-së lidhur me shkeljen dhe lartësinë gjobës. Kjo për faktin se PZAP-i, me rastin e shqiptimit të gjobës së lartpërmendur, ka marr parasysh një mori rrethanash të precizuara më afër në arsyetimin e vendimit të tij, dhe se lartësia e gjobës e paraparë për një shkelje të tillë sipas nenit 120 paragrafi 1 pika 3, të Ligjit për zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nr.08-228, është deri në 50.000 €, Gjykata Supreme vlerëson se dënimi i shqiptuar këtij subjekti politik në lartësi prej 6,000 €, është i drejtë dhe i ligjshëm, për faktin se çështja ka të bëjë edhe me recidivizëm, sepse ky subjekt politik është gjobitur edhe më herët për gjuhë të pa përshtatshme në fushatë zgjedhore, prandaj me lartësinë sa i përket gjobës së shqiptuar vlerësohet se do të arrihet qëllimi ligjor i tij, jo vetëm ndëshkimi i shkelësve të dispozitave të Kodit të Mirësjelljes të subjektit politik, mbështetësve dhe kandidatëve të tyre, por edhe korrektimi i shkeljeve të ndryshme zgjedhore dhe sigurimi i mbarëvajtjes së këtyre dhe zgjedhjeve të tjera, si dhe ndikimi edhe në subjektet e tjera politike që garojnë në zgjedhje, që me përpikëri të zbatojnë dispozitat e Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme pretendimet e subjektit politik për formën dhe përmbajtjen e vendimit janë të pabazuara për faktin se, vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, e cila konstatoi se në rastin konkret edhe e drejta materiale, po ashtu është zbatuar drejt.

Pretendimet sa i përket faktit se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, nuk ka pas legjitimitet për të ushtruar ankesë sepse askush në fjalim nuk i është drejtuar këtij subjekti, Gjykata Supreme i vlerëson si të pa bazuara. Në rastin konkret fyerja i është drejtuar subjekteve tjera politike dhe në këtë rast ka përfshi edhe subjektin politik LDK dhe e njëjta është në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartcekura të LZP-së, prandaj e njëjta ka pasur legjitimitet të plotë në parashtrimin e ankesës.

Në raport me pretendimet e PZAP-së në përgjigje në ankesë se ankesa e subjektit politik LVV, duhet të hedhet si e pasafatshme, Gjykata Supreme vlerëson se një pretendim i tillë është i pa bazuar. Nga shkresat e lëndës, konkretisht nga fletkthesa për dorëzim personal të bashkangjitur nga PZAP, shihet se ka mospërputhje të datës së dorëzimit të vendimit me datën e nxjerrjes së vendimit. Nga e njëjta fletkthes rezulton fakti se vendimi i PZAP-së del të jetë dorëzuar subjektit politik LVV, një ditë para nxjerrjes së tij, gjegjësisht me datën 23.01.2025 ndërsa vendimi i PZAP-it është me datën 24.01.2025, që nënkupton se në këtë rast kemi të bëjmë me gabim teknik në shënimin e datës së pranimit të vendimit nga subjekti politik VV, prandaj nga një gjendje e tillë e çështjes Gjykata Supreme vendosi që ankesën ta trajtoj në mënyrë meritore dhe të vendos ashtu si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.



Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtruesit të ankesës, prandaj, pretendimet në ankesë lidhur shkeljen e Kodit dhe me gjobën e shqiptuar u refuzuan si të pa bazuara sepse si të tilla nuk dëshmuuan se përmbushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa që të prezantohen fakteve të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, 120.1.3 dhe 34.1 (11), të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
AA.nr.13/2025, datë 29.01.2025.

Kryetarja e kolegjit,
Franciska Zhitija - Ymeri



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik
[Signature]